

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KRYETARI**

Nr. 1257/ prot.
8

Pogradec, më 16, 03, 2022

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

**Z. Sotiraq Mangëri
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për miratimin e titullit të nderit “ KRENARIA E QYTETIT ”

Me respekt,


KRYETARI

Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 (dy)

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2 (dy)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI**

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ . 2022

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ datë _____ 2021

**PËR MIRATIMIN E TITULLIT
“ KRENARIA E QYTETIT”**

Llazi Kërxballi

Nexhmi Starova (Pas vdekjes)

Ilir Luarasi (Pas Vdekjes)

Liljana Busho (Qeleshi)

Virgjil Maçolli

Këshilli Bashkiak Pogradec në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ . 2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Pogradec dhe me miratim nga Komisioni Këshillimor për dhënien e titujve të nderit, mbështetur në Ligjin nr 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 54 germa “m” e tij, ligjit nr. 112/2013 “Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr 861 datë 10.02.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve Këshillimore për dhënien e Medaljeve dhe Titujve Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë dhe Rregullores së Bashkisë Pogradec “Për llojet e Titujve të Nderit, Kriteret dhe Procedurën e dhënies së tyre” Neni 5.

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e dhënies së titullit të nderit “ **KRENARIA E QYTETIT**”

- Llazi Kërxballi

Me motivacion: Për kontributin e shquar dhe rezultate të larta kombëtare që ka dhënë ndër vite si sportist , trajner dhe pjesmarrës aktiv në lëvizjen artistike amatore në qytetin e Pogradecit duke qenë shëmbull për brezat e rinj.



- **Nexhmi Starova (Pas Vdekjes)**

Me motivacion: **Për kontributin e shquar dhe rezultate të larta kombëtare si si sportist rekordmen për të rinj ndër vite duke qenë shembull për brezat e rinj.**

- **Ilir Luarasi (Pas Vdekjes)**

Me motivacion: **Për kontributin e shquar dhe rezultate të larta që ka dhënë ndër vite si sportist , trajner dhe mësues në qytetin e Pogradecit duke qenë shembull për brezat e rinj.**

- **Liljana Busho (Qeleshi) Mjeshtre e Sportit**

Me motivacion: **Për kontributin e shquar dhe rezultate të larta kombëtare si si sportiste rekordmene për të reja ndër vite duke qenë shembull për brezat e rinj.**


- **Virgjil Maçolli**

Me motivacion: **Për kontributin e shquar dhe rezultate të larta që ka dhënë ndër vite si sportist , trajner në qytetin e Pogradecit duke qenë shembull për brezat e rinj.**

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni Këshillimor për dhëniën e Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pogradec.

K R Y E T A R

Sotiraq MANGËRI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. _____ prot.

Pogradec, më __, __, 2022

RELACION

1. Në lidhje me Projekt-Vendimin për miratimin e titullit të nderit “ KRENARIA E QYTETIT”
Për

Llazi Kërzhalli
Nexhmi Starova (Pas Vdekjes)
Ilir Luarasi (Pas Vdekjes)
Liljana Busho (Qeleshi) Mjeshtre e Sportit
Virgjil Maçolli

I nderuar Kryetar i Këshillit!

Të nderuar Këshilltarë!

Propozimet e mësipërme për dhënien e titujve të nderit “KRENARIA E QYTETIT “ bëhen në kuadër të përvjetorit të ngritjes së Shoqërisë së parë sportive dhe kulturore “**TRUPI GJIMNASTIK**” në **14 mars 1915**. Kjo Shoqatë e cila kishte objektivin kryesor “ **Edukimin e fëmijëve dhe të rinjve me ndjenja kombëtare dhe zhvillimin e tyre fizik**” morri përsipër në ato vite të vështira barrën e rëndë të edukimit fizik dhe kulturor të rinjve pogradecarë.

Mitrush Kuteli do të thotë: Një flamur ishte ngritur më parë në vitin 1913, por atë nuk e mbaj mënd mirë. Por një flamur tjetër u ngrit në Pogradec në fillim të vitit 1915 , ay i Shoqërisë “Trupi Gjmnastik”.

Sipas dokumenteve kjo Shoqëri do të mbështetet nga patriotë ,mësues , qytetarë dhe të rinj të cilët me aktivitetet e organizuara i dhanë tjetër gjallëri jetës sportive dhe kulturore Pogradecit në ato vite.

Projekt vendimi që po ju paraqesim është rrjedhojë e detyrimit ligjor që ka Institucioni i Bashkisë Pogradec, për të bërë të mundur dhënien për miratimin e titullit të nderit “KRENARIA E QYTETIT” , por dhe detyrimi shpirtëror për gjithë secilin për kontributin e dhënë ndër vite në jetën sportive dhe edukimit fizik në Pogradec.

Kërkojmë nga ana e Këshillit Bashkiak të akordojë titullin “KRENARIA E QYTETIT” për:



- **Llazi Kërzhalli**

Me motivacion: Për kontributin e shquar dhe rezultate të larta kombëtare që ka dhënë ndër vite si sportist , trajner dhe pjesmarrës aktiv në lëvizjen artistike amatore në qytetin e Pogradecit duke qenë shëmbull për brezat e rinj.

- **Nexhmi Starova (Pas Vdekjes)**

Me motivacion: Për kontributin e shquar dhe rezultate të larta kombëtare si si sportist rekordmen për të rinj ndër vite duke qenë shëmbull për brezat e rinj.

- **Ilir Luarasi (Pas Vdekjes)**

Me motivacion: Për kontributin e shquar dhe rezultate të larta që ka dhënë ndër vite si sportist , trajner dhe mësues në qytetin e Pogradecit duke qenë shëmbull për brezat e rinj.

- **Liljana Busho (Qeleshi) Mjeshtre e Sportit**

Me motivacion: Për kontributin e shquar dhe rezultate të larta kombëtare si si sportiste rekordmene për të reja ndër vite duke qenë shëmbull për brezat e rinj.

- **Virgjil Maçolli**

Me motivacion: Për kontributin e shquar dhe rezultate të larta që ka dhënë ndër vite si sportist , trajner në qytetin e Pogradecit duke qenë shëmbull për brezat e rinj.

Ftojme Këshilltarët të votojnë këtë Projekt Vendim.

Faleminderit!

Konceptoi: Juriste

Irena Berberi

Pranoi: Kryetare e Komisionit Këshillimor
Për dhënie të titujve të nderit

Entela Gushe

Miratoi: NËNKRYETAR

Johan Sterjo

Konfirmoi: KRYETAR

Ilir Xhakolli

